



RÖFIX PE 312 OUT DOOR

Bojë akrilike për fasada.

Udhëzime teknike dhe ligjore:

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skemat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit (UNI, ÖNORM, SIA, etj), si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve (p.sh. SMGV, ÖAP, QG -WDS).

Fushat e përdorimit:

Bojë për fasada me aftësi të lartë mbushëse mbi bazamente të suvatuara. Me bazë Polymer - Acrylate shumë cilësore, optimale për një jetëgjatësi dhe përdorim shumë të mirë.

Karakteristikat:

- Aftësi të lartë mbuluese
- Pigmente ngjyrash standarte
- Pa përbërje holluesi ose nafti.

Përpunimi:



Të dhëna teknike						
SAP-Art. Nr.:	2000151523					
NAV-Art. Nr.:	132207	132208	132209	132210	132211	132212
Informacion mbi produktin	Mund të përdorni edhe bojën për fasada RÖFIX					
Lloji i paketimit						
Njesi per palete	24 Nj./Pal	24 Nj./Pal	24 Nj./Pal	24 Nj./Pal	24 Nj./Pal	24 Nj./Pal
Sasi për njësi	15 lt./Nj.					
Ngjyra	E bardhë	(PK I) Me ngjyrë	I ngjyrosur PK II	I ngjyrosur PK III	I ngjyrosur PK IV	I ngjyrosur PK V
Konsumi	ca. 0,15 ltr./m ² /Lyerje					
Pesha specifike	ca. 1,57 kg/ltr.					
Vlera SD	ca. 1 m					
Vlera e pH	ca. 9,8					
Kategoria VOC	C					
Përmbajtje VOC	max. 1,3 g/ltr.					
Kodi VOC	2004/42/IIA(c)75(2007)40(2010)40					
Kapilariteti	ca. 0,09 kg/m ² h					
Grada e shkëlqimit	mat					
Këshilla për paketimin	Në kova plastike të riciklueshme					
Temperatura e bazamentit	5 - 25 °C					
Klasa e ngjyrave		Kategoria e ngjyrave I	Kategoria e ngjyrave II	Kategoria e ngjyrave III	Kategoria e ngjyrave IV	Kategoria e ngjyrave V

Baza e materialit:

- Pigmente: dioksid titani, karbonat kalciumi, silikat alumini
- Lidhës: Polymer-Dispersion
- Përbërësit: me përbërje fijesh, eliminues i shkurës

Kushtet e punimit:

Gajtë përpunimit- dhe tharjes së materialit, ambjenti përreth ose temperatura e bazamentit nuk duhet të jetë poshtë +5°C. Koha e tharjes është e varur nga kushtet e ambjentit rrethues. Nëse kemi një lagështirë ajri prej 65% dhe një temperaturë ambjenti prej 20°C, pas afërsisht 5 orësh bazamenti do të jetë tharrë dhe mund të lyhet sipër. Një tharje të plotë e arrijmë pas afërsisht 3 ditësh.

Deri në tharjen e plotë të sipërfaqes, duhet ta mbronni këtë të fundit nga kushtet atmosferike, i ftohti, ngrirja, i nxehti, rrezet direkt të diellit, lagështira, shiu, era, etj..



RÖFIX PE 312 OUT DOOR

Bojë akrilike për fasada.

Bazamenti:	<p>Bazamenti duhet të jetë i pastër, i qëndrueshëm, i thatë, me aftësi mbajtëse, i lirë nga pluhurat, shpërthimet, elementët ndarës, koret dhe papastërtitë e çdo lloji.</p> <p>Bazamentet me aftësi të lartë thithje, ranorë dhe me aftësi të ndryshme thithje duhet të lyhen paraprakisht me astarin/fortësuesin përkatës.</p> <p>Prova e sipërfaqes, -klasifikimi dhe -parapërgatitja sipas rregullave nacionale: DIN 18363, Skeda-BFS, ÖAP ose SMGV. Për bazamente të sapo ndërtuara, duhen respektuar koha e tharjes- koha e lenies nga ana e ndërtuesit të bazamentit, si dhe të dhënat teknike dhe këshillat e tij, në lidhje me këtë produkt.</p> <p>Bazamentet duhet të kenë aftësi mbajtëse të lartë. Gjatë prerjes së vijave diagonale, duhet të arrihet vlera 0 dhe 1 sipas EN 2409.</p>
Bazamenti Trajtimi paraprak:	<p>Beton: Sipërfaqet e betonit duhet të jenë të thara, mbajtëse, dhe të fshira mirë d.m.th pa pluhura. Gjithashtu nëse kemi mbetje çimneto, duhen hequr dhe ato plotësisht. Papastërtitë të çdo lloji natyre, si vajra, graso parafinë ose mbejtje të ndryshme, duhen pastruar me sprucues avulli. Vrima ose dëmtime të ndryshme të sipërfaqes mund ti përmirësoni, rinovoni me masë shpatulluese RÖFIX.Lyerjen e parë dhe të fundit me produktin e përshkruar në këtë skedë.</p> <p>Suva mbushëse e grupit të Ilaçërave II dhe III: me bazë gëlqere / çimento: Parapërgatitja e bazamentit me astar sugjerohet nga ana jonë, pamvarsisht se në rast bazamentesh me aftësi thithëse normale- psh. suva të reja RÖFIX që i përkasin grupeve të përshkruara këtu. Parapërgatitja e bazamentit me RÖFIX PP 301 HYDRO LF - Hydrosol astar. RÖFIX PP 301 duhet të hollohet me ujë duke ju përshtatur aftësive thithëse të bazamentit.Lyerjen e parë dhe të fundit me produktin e përshkruar në këtë skedë.</p> <p>Shtresa (Alt-) dhe lyerje të forta (Alt-) me bazë dispersioni: Paratrajtimi i bazamentit me astar është i këshillueshëm.Parapërgatitja e bazamentit me RÖFIX PP 301 HYDRO LF - Hydrosol astar. RÖFIX PP 301 duhet të hollohet me ujë duke ju përshtatur aftësive thithëse të bazamentit. Lyerjen e parë dhe të fundit me produktin e përshkruar në këtë skedë.</p> <p>Bazamente të miksuara, sipërfaqe të vogla të suvatuara - rinuvuara, (psh. përmirësim suvatimi, krisje të shpatulluara, suvatime dhe shpatullime, kanalizime të reja elektrike, etj.): Parapërgatitja e bazamentit me RÖFIX PP 301 HYDRO LF - Hydrosol astar. RÖFIX PP 301 duhet të hollohet me ujë duke ju përshtatur aftësive thithëse të bazamentit.Lyerjen e parë dhe të fundit me produktin e përshkruar në këtë skedë.Kujdes me bazamentet e vjetra dhe të papastra - rrezik zverdhje (Izolimi i bazamentit duhet të bëhet patjetër).Opsionale:Metoda - RÖFIX ISO: Parapërgatitja e bazamentit dhe lyerja e parë me RÖFIX PP 307 ISO LF (max. 10% hollim) në një dorë. Më pas lyerja përfundimtare me produktin e përshkruar në këtë skedë teknike.</p> <p>Suva mbushëse të të gjitha llojeve të Ilaçërave (gëlqere; gëlqere- cimento; cimento; gips; gips- gëlqere): Shtresat ose sipërfaqet të cilat edhe pas parapërgatitjes së bazamentit me astarët/fortësuesit e këshilluar si psh. RÖFIX PP 201 SILICA LF, PP 401 SILCO LF, PP 301 HYDRO LF ose PP 307 ISO LF nuk kanë arritur ende fortësinë mbajtëse, duhen (Këshillë: prerja e kryqezuar sipas EN 2409), të prishen në mënyrë mekanike.</p>
Bazamenti-Trajtimi paraprak:	<p>Mbulimi përpara aplikimit: sipërfaqe të tjera të ambientit, si xhama, qeramik, alumin, dritare, sipërfaqe druri, mobilje, dysheme, etj. duhen veshur-mbuluar. Pika të freskëta boje duhen fshirë me një leckë të njomë me ujë.</p> <p>Hollimi i lëndës lidhëse/astarit (PP 201, PP 301, PP 401) bëhet me ujë dhe duhet vlerësuar në raport me aftësinë thithëse të suvasë mbushëse. Lidhësi duhet të thithet mirë nga bazamenti - nuk duhet të formohen shtresa të shkelqyeshme filmi të hollë.</p>
Përgatitja:	<p>Për dorën e parë ose të ndërmjetme: perziejeni me max. 10% ujë.</p> <p>Shtresën/Lyerjen përfundimtare: perziejeni me max. 3% ujë.</p> <p>Produkti është i përpunueshëm edhe pas një hollimi të lartë, vlerat e të cilit (fortësia, fuqia mbuluese, bashkimi i kokërrizave, grada e shkëlqimit, grada e bardhësisë, etj.) nuk mund të arrihen më si të parashikuara në skedën teknike.</p>
Përpunimi:	<p>Shtrimi vijon i plotë, i njëtrajtshëm, duke mbuluar gjithshka, me anë të një furce, apo rruli.</p> <p>Rrul 2 herë</p> <p>Furçë 2 herë</p> <p>Airless-pajisje sprucuese</p> <p>Nëse do të lyeni me pompë, boja duhet të përzihet dhe të sitet mirë përpara se të aplikohet.</p> <p>Makineri sprucuese për suva të njoma</p>



RÖFIX PE 312 OUT DOOR

Bojë akrilike për fasada.

Këshilla për heqjen e mbeturinave: Për veshjen e bazamenteve duhet të respektohen rregullat nacionale si dhe ato europiane. Mbi të gjitha rregullat e përpunimit dhe ato rakorduese të standateve internacionale si psh. ÖAP, SMGV ose Skedat - BFS, etj. Në rast të ndonjë konflikti, jeni të lutur të na kontaktoni.

Këshilla në rast reziku: Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda. Mbajini larg nga fëmijët. Nëse e prekni me duar ose ju bie në sy, pastrojeni me ujë të vazhdueshëm deri në një shplarje të plotë. Nëse e përpunoni me pompe sprucuese, bëni kujdes të mos e thithni me hundë. Mos e hidhni në ujë, kanalizime ose në tokë. Informacione më të detajuara i gjeni në skedën e sigurisë. Vetëm kovat boshe mund ti jepni për riciklim. Deklarimi („mbeturinat“) për shkatërrim sipas rregullave europiane AVV. Ndihma e parë dhe masat paraprake, sipas skedës së sigurisë.

Keshilla per përpunimin: Një sipërfaqe e njëtrajtshme duhet të aplikohet në një dorë „e freskët mbi të freskët“ ose më saktë „e njomë mbi të njomë“ për të shmangur disnivelet. Në raste ngjyrash të errëta dhe intensive me gradë reflektimi <20% HBW, ne ju sygjerojmë sistemin RÖFIX SycoTec të fasadave. Ju lutem për këtë drejtohuni pranë specialistëve tanë.

Magazinimi: Magazinijini në vende të freskëta, ku nuk kanë mundësi të ngrijnë dhe të jenë të mbyllura hermetikisht. Magazinimi min. 24 muaj.

:



Këshilla të përgjithshme: Kjo skedë teknike anulon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkohen edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkohë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në veteve nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet RÖFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohej një cilësi e pandryshueshme. Vlerat teknike janë bazuar tek produktet bazë. Gjatë pigmentimit ose ngjyrosjes, janë të mundshme edhe devijime nga të dhënat teknike. Në dhënien e vlerave bëhet fjalë për vlera mesatare. Meqënëse produktet tona përbëhen nga materiale natyrore, mund të ndodhë që në një ngarkesë të kemi edhe devijime minimale të vlerave. Për veshjen e sipërfaqeve, të cilat këtu nuk janë përshkruar, do të ishte i nevojshëm një marrje mendimi nga ana jonë. Në rast porosie plotësuese ose në lidhje me katalogun e ngjyrave, pigmentet mund të ndryshojnë minimalisht, prandaj dhe në kantieri duhet të bëni si fillim një mostër për krahasim. Të dhënat në lidhje me kohën e pritjes-veprimit janë percaktuar në kushtet e laboratorit (20°C/65%Lageshtirë/e mbetur) dhe sipas kushteve të kantierit mund të ndryshojnë. Të dhënat janë pa rrezik për vërtetësinë dhe plotësinë dhe pa detyrime për kërkesa të çdo natyre, si dhe të rezolutave të klientit. Janë të vlefshme edhe Skedat Teknike të produkteve RÖFIX, të cilat janë të përmëndura edhe në këtë skedë teknike. Shërbimi ynë i konsulencës teknike është në dispozicionin tuaj në rast pyetjesh lidhur me përdorimin, përpunimin si dhe demonstrimin e produkteve tona. Stafii ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona.